

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“MZIU KOMPANI“ SHPK**

**Neni 1: Emri dhe forma ligjore**

Sot më datë 14.04.2021, unë i nënshkruari:

1. **Kastriot Kotica**, i datëlindjes 05.05.1990, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me numër identifikimi J00505016M

themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin :

---

**“MZIU KOMPANI“ SHPK**

Shoqëria rregullon veprimtarinë e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

**Neni 2: Selia**

**Katund i Ri, Sektor Rinia, Rruga Kotica, Zona Kadastrale 2574, Nr.Pasurie 55/66, Durrës.**

Shoqëria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

**Neni 3: Objekti**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Import- eksport makineri, mjete bujqësore dhe makineri të ndryshme, automjete, si dhe pjesë këmbimi e tregtim me shumicë e pakicë të tyre, import-eksport e

prodhim materiale ndërtimi, si dhe tregtimin e tyre me shumicë e pakicë, import-eksport të prodhimeve bujqësore e blegtorale, si dhe tregtimin e tyre me shumicë e pakicë. Import-eksport të mallrave të ndryshme si dhe tregtimin e tyre me shumicë e pakicë. Shërbim riparimi makineri e mjete të ndryshme. Konsulencë, shërbim menaxhimi.

- Ndërtimi, rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e objekteve civile, turistike, shëndetësore, shoqërore, kulturore, tregtare, sportive, industriale, veshje fasada, vepra kullimi dhe infrastrukture, shërbime komunale, rrugë, ura, punime bonifikimi, etj. Projektimi i objekteve të sipërcituara, asistencë, mbikqyrje dhe ekspertizë teknike. Nxjerrjen, përpunimin e prodhim të gurit, materialeve inerte në përgjithësi. Punime bonifikimi, elektrike, hidraulike. Import-eksport të materialeve të ndryshëm.
- Shërbime hotelerie dhe turistike të të gjitha llojeve, bar, restorant, marrje dhe dhënie automjesh me qera, shërbimi me qëllim promovimin dhe nxitjen e turizmit, çdo aktivitet tjetër që lidhet direkt apo indirekt me aktivitetet e lartpërmendura, shkëmbim apo çdo transaksion tregtar në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme.
- Agjensi imobiliare.
- Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohej me ligj (sipas nenit 7 të Ligjit nr.9901, dt.14.04.08).

#### **Neni 4: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

#### **Neni 5: Kapitali**

Kapitali i shoqërisë është **100.000 (njëqindmijë)** Lekë, i ndarë në 1 kuotë.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

**Kastriot Kotica**, është zotërues e 1 kuote, me 100% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlerën 100.000 lekë.

#### **Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Kastriot Kotica**, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

#### **Neni 7: Viti ushtrimor**

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

#### **Neni 8: Dispozitat e fundit**

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Shoqërisë

Kastriot Kotica

Kastriot Kotico 